

20231542757

**LIGJ PËR GARANCI TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT TË
DETYRIMEVE SIPAS MARRËVESHJES SË HUAS PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT
TË PËRKRAHJES SË LIKUIDITETIT TË SHA TMV – SHKUP NË KUSHTET E
KRIZËS ENERGJETIKE, QË DO TË LIDHET NDËRMJET BANKËS EUROPIANE TË
RINDËRTIMIT DHE TË ZHVILLIMIT DHE SHOQATËS AKSIONARE PËR
PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE TERMOCENTRALET E MAQEDONISË SË
VERIUT, NË PRONËSI SHTETËRORE, SHKUP**

Neni 1

Republika e Maqedonisë së Veriut garanton shlyerjen e detyrimeve dhe përbushjen e dispozitave të Marrëveshjes së huas për financimin e Projektit të përkrahjes së likuiditetit të SHA TMV – Shkup në kushtet e krizës energjetike, që do të lidhet ndërmjet Bankës Europiane të Rindërtimit dhe të Zhvillimit dhe Shoqërisë Aksionare për Prodhimin e Energjisë Elektrike Termocentralet e Maqedonisë së Veriut, në pronësi shtetërore, Shkup, në vlerë prej 100.000.000 euro, nëse Shoqëria Aksionare për Prodhimin e Energjisë Elektrike Termocentralet e Maqedonisë së Veriut, në pronësi shtetërore, Shkup nuk i përbush dhe nuk i servison detyrimet sipas Marrëveshjes së huas.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas përcaktohen me Marrëveshjen e huas të nenit 1 të këtij ligji, që do të lidhet ndërmjet Bankës Europiane të Rindërtimit dhe të Zhvillimit dhe Shoqërisë Aksionare për Prodhimin e Energjisë Elektrike Termocentralet e Maqedonisë së Veriut, në pronësi shtetërore, Shkup, për financimin e Projektit të përkrahjes së likuiditetit të SHA TMV – Shkup në kushtet e krizës energjetike.

Neni 3

Të gjitha detyrimet financiare që rezultojnë nga Marrëveshja e huas e nenit 1 të këtij ligji, si dhe servisimi i huas do të shlyhet nga Shoqëria Aksionare për Prodhimin e Energjisë Elektrike Termocentralet e Maqedonisë së Veriut, në pronësi shtetërore, Shkup, nga të hyrat e realizuara, në afatet dhe kushtet e përcaktuara në Marrëveshjen e huas të nenit 1 të këtij ligji.

Neni 4

Afati i pagesës së huas së nenit 1 të këtij ligji është pesë vjet, me grejs periudhë të përfshirë prej gjashtë muajve.

Shoqëria Aksionare për Prodhimin e Energjisë Elektrike Termocentralet e Maqedonisë së Veriut, në pronësi shtetërore, Shkup, do të kryejë pagesën në nëntë këste gjysmëvjetore, që do të arrijnë për pagesë më 10 shkurt dhe 10 gusht të çdo viti, siç përcaktohet me Marrëveshjen e huas të nenit 1 të këtij ligji.

Norma e interesit është variabile dhe përbëhet nga EURIBOR-i gjashtëmujor i rritur për margjinë prej 1%.

Shoqëria Aksionare për Prodhimin e Energjisë Elektrike Termocentralet e Maqedonisë së Veriut, në pronësi shtetërore, Shkup, do t'i paguajë Bankës Europiane të Rindërtimit dhe të Zhvillimit provizion të njëhershëm prej 1% të vlerës së huas.

Shoqëria Aksionare për Prodhimin e Energjisë Elektrike Termocentralet e Maqedonisë së Veriut, në pronësi shtetërore, Shkup, do t'i paguajë Bankës Europiane të Rindërtimit dhe të Zhvillimit provizion prej 0.5% nga pjesa e patërhequr e huas në nivel vjetor.

Neni 5

Për rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve reciproke që rezultojnë nga Marrëveshja e huas e nenit 1 të këtij ligji dhe Marrëveshja e garancisë, Ministria e Financave dhe Shoqëria Aksionare për Prodhimin e Energjisë Elektrike Termocentralet e Maqedonisë së Veriut, në pronësi shtetërore, Shkup, do të lidhin marrëveshje të veçantë.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi ditën e botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.